

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije
Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo
Departamenti i Ankesave
Nr. Prof. 453/22 Data 06/12/2022
PRISHTINË

ANKESAV



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo



ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS (ATK) - Divizioni i Ankesave – në përbërje të panelit shqyrtues: Ilona Mrasori kryesuese, Ramadan Ahmeti dhe Emine Nikqi anëtarë të panelit - njeherit procesmbajtëse duke vendosur në çështjen administrative tatimore, sipas ankesës së subjektit [redacted], me numër unik identifikues NUI: [redacted] me adresë fsh [redacted] dorëzuar në Divizionin e Ankesave me datë 21/10/2022 me nr. protokollit 453/22, kundër vendimit mbi Njoftim-Rivlerësimet për Tatimin Shtesë, të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Ferizaj, në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 03/L-222 „Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”, në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 11/11/2022, në prezencë të palëve: [redacted] përfaqësues i biznesit, Refik Bislimi - inspektor i kontrollit, Valbona Sylja – nga zyra e avokatit të tatimpaguesit mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht ankesa nr. 453/22 e datë 21/10/2022 e tatimpaguesit [redacted], me NUI: [redacted] pronar [redacted], adresa fsh [redacted] në mbështetje të nenit 132/4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurat Administrative, në lidhje me nenin 89, paragrafin 2, të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedura.

II. Ndryshohet Njoftim Rivlerësimi për PD/2018 për Tatimin në të Ardhura Individuale, duke eliminuar qarkullim shtese ne vlere prej 47,000.00€ , Ndryshohet Njoftim Rivlerësimi për TVSH 12/2018 duke eliminuar qarkullim shtese ne vlere prej 47,000.00€ si dhe CI për TM1/2018, TM2/2018, TM 3/2018 duke korigjuar vlerësimet nga 600€ me procedure te kontrollës ne 367.96 € sipas Divizionit te Ankeses.

Pjesa e mbetur pas ndryshimeve mbetet obligim për pagesë për tatimpaguesin.

A r s y e t i m

Tatimpaguesi ka dorëzuar ankesë në Divizionin e Ankesave më datë 21/10/2022, ndërkaq Njoftim Rivlerësimet nga Kontrolli dhe Procedurën e ankesës e ka pranuar më datë 27/09/2022, që për rrjedhojë ankesa është parashtruar në afatin ligjor prej 30 ditësh e përcaktuar me nenin 77.2 të Ligjit Nr. 03/L-222 "Mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore".

Vlerësimi i kontrollit:

Kontrolli ka filluar me datë 24/01/2022, me ç' rast tatimpaguesit është njoftuar për procedurë kontrolli përmes Dokumenti i Kërkesës së Informatave AU003 i cili është dorëzuar me datë 31/01/2022 dhe zhvillimin e intervistës fillestare me të njëjtën datë.

Objekt kontrolli ka qenë: Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH) për periudhën tatimore 01/2018-12/2019, Tatimi në të Ardhura Individuale (PD) për periudhën tatimore 2018-2019 dhe Kontributet Individuale (CI) TM1/2018 – TM4/2019.

Gjatë procesit të kontrollit, është vlerësuar përmes metodës indirekte, konkretisht me metodën e depozitave bankare. Veprimtaria e biznesit është shitja e pajisjeve bujqësore. Numri i të punësuarve është 5-6 punëtor.

Tatimpaguesi në ankesën e datës 07/10/2022, konteston raportin e kontrollit të datës 27/09/2022 të lëshuar nga Administrata Tatimore Drejtoria Rajonale Ferizaj. Kontrolli tatimor nuk e ka marrë parasysh dokumentacionin e ofruar nga tatimpaguesi për shitjet i ka konstatuar duke u bazuar vetëm në qarkullim bankar me llogarinë bankare, duke mos bërë analize të plote dhe duke e konsideruar të gjithë kolonën kredi (hyrjet monetare) të raportit bankar si shitje, gjë që është në kundërshtim të plote me qasjen profesionale. Për vitin 2018:

Qarkullimi përmes bankës është 300,544.00€

Qarkullimi sipas librave të shitjes është 298,499.62€

Dallimi ndërmjet librave të shitjes dhe qarkullimit bankar është 2,000.00€

Tërheqjen e mjeteve në vlerë prej 47.000,00 € të kryer tek llogaria bankare tek Banka Ekonomike më 31.12.2018 nga llogaria e biznesit në llogarinë personale, e cila vlerë e njëjtë është kthyer në llogarinë e biznesit më 03.01.2019 (vetëm pas tri ditësh), kontrolli tatimor e konsideron si qarkullim shtesë, duke e ndryshuar krejtësisht deklaratën tatimore të vitit 2018 me obligime tatimore pothuaj vetëm nga ky transaksion..

Edhe për vitin 2019, Kontrolli tatimor nuk e ka marrë parasysh dokumentacionin e ofruar nga tatimpaguesi për shitjet i ka konstatuar duke u bazuar vetëm në qarkullim bankar me llogarinë bankare, duke mos bërë analize të plote dhe duke e konsideruar të gjithë kolonën kredi (hyrjet monetare) të raportit bankar si shitje, gjë që është në kundërshtim të plote me qasjen profesionale. Për vitin 2018:

Qarkullimi përmes bankës është 134,132.19€

Qarkullimi sipas librave të shitjes është 54,963.50€

Dallimi ndërmjet librave të shitjes dhe qarkullimit bankar është 7,169.14€

Me një shikim rutinor të qarkullimit bankar për vitin 2019 mund të konstatohet p.sh. se më 01.03.2019 vlera prej 23.000,00 € nuk mund të konsiderohet si shitje, sepse ky është një huazim i marrë nga subjekti tatimor [redacted] për mbulimin e linjës kreditore të njëjtën ditë dhe më 04.03.2019 (pas 3 ditësh) e njëjta vlerë (23.000,00 €) i është kthyer subjektit [redacted]. Edhe në këtë rast, kjo është lehtë e identifikueshme, sepse me rastin e kthimit të mjeteve përshkrimi është: [redacted] kthim huazimi. Rast të ngjashëm kemi edhe me vlerën prej 18.000,00 € të datës 01.07.2019 e cila me automatizëm nga kontrolli tatimor konsiderohet si qarkullim, ndonëse këto mjete janë kthim i pjesërishtë nga tërheqja prej llogarisë biznesore në atë private më 28.06.2019 në shumë prej 21.000,00€.

Divizioni i Ankesave në bazë të nenit 95 të Ligjit Nr. 05/L – 031 Mbi Procedurat e Përgjithshme Administrative ka organizuar seancën e dëgjimit më datë 11/11/2022, në të cilën të pranishëm ishin të gjitha palët e ftuara në mënyrë të rregullt, përveç zyrës ligjore.

Përfaqësuesi i tatimpaguesit në të drejtën e fjalës theksoj se të gjitha hyrjet janë trajtuar si hyrje në raportin e bankës në Bankën Ekonomike. Pika kryesore është tërheqja në vlerën

47,000.00€ me 31.12.2018 nga llogaria e biznesit ne BE ne llogarinë individuale e cila është kthyer me date 03.01.2019. Kontrolli e vlerëson si qarkullim shtese . Ne nuk kemi kryer asnjë transaksion me këto mjete. Transaksioni prej 20,000.00€ te linja kreditore me date 26.02.2018 , kjo vlere nuk mund te trajtohet si e hyrë për arsye se edhe ne llogari bankare shkruhet transfer intern .

Ne vitin 2019 vlere 23,000.00 € është huazim nga [redacted] është marr për mbulim te linjës kreditore e cila është marr nga vëllai i tij dhe nuk janë kërkuar kontratat e huazimit . Kthimi i huazimit është bere 18,000.00€ me 01.07.2019 . Këto mjete janë kthyer pjesërisht nga tërheqja e llogarisë biznesit ne atë periudhe me 28.06.2019.

Inspektori i kontrollës theksoj se ne draft raport tatimpaguesi nuk ka sjell dokumente shtese për shkakun e tërheqjes se vlerës 47,000.00 € nga 31.12.2018 dhe kthimi me 03.01.2019 nga llogaria bankare e biznesit ne llogarinë individuale . Ne kemi vlerësuar se qëllimi ka qene me i ik qarkullimit ne pasqyra vjetore 2018.Diferenca ne mes te librave dhe qarkullimit bankare është 2,000.00€ plus 47000 nga transferi dhe totali është 49,000.00€. Sa i përket vlerës 23,000.00€ kemi kërkuar nga tatimpaguesi qe te prezantoj kontratën e huazimit , mirëpo nuk e ka prezantuar.

Administrata Tatimore – Divizioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave në lëndë si dhe pretendimeve ankimore konstaton se: Ankesa e tatimpaguesit është pjesërisht e bazuar.

Divizioni i Ankesave pas vlerësimit të provave materiale në shkresat e lëndës si: Raporti i Kontrollit datë 27/09/2022, Njoftim Rivlerësimeve pas kontrollit, Fletave të Punës së Kontrollit, vlerësimit të provave të bashkangjitura ankesës së dorëzuar me shkrim dhe analizimit të pretendimeve ankimore vendos se ankesa e tatimpaguesit është pjesërisht e bazuar.

Dispozitivi i këtij Vendimi të Divizionit të Ankesave është i mbështetur në faktet në vijim:

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike , divizioni i ankesave në procedurën e provave të shqyrtimit ka administruar provat relevante dhe atë : raportin e kontrollit te datës 27/09/2022, njoftim vlerësimit -fletat e punës së kontrollit , ankesën e tatimpaguesit dhe provat e bashkangjitura , llogarite bankare, dhe nga të njëjta DA, nxjerr konstatimin se: ATK-DR-Ferizaj ka kryer kontrollit tatimor tek subjekti „ [redacted] ” për llojin e tatimit TVSH për periudhat tatimore 01/2018-12/2019 , PD për periudhën tatimore 2018-2019 dhe CI për periudhën TM1/2018 – TM 4/2019 dhe si rezultat i vlerësimit nga ana e kontrollit rezulton me tatim shtese ne vlere 13,247.50€ (vlere të marra nga r. i kontrollit) pa përfshirë ndëshkimet dhe interesin e kalkuluar sipas ligjit.

Divizioni i Ankesave konstaton se kontrolli ka kryer kontrollin ne te cilin deponimet janë trajtuar si te hyra shtese për qëllime te tatimit ne fitim ne (TAP 2018 -2019) . Mirëpo Divizioni i Ankesave vendos se ne rasti e transferit te mjeteve ne vlere prej 47,000.00€, nuk është interpretuar drejte 3.2. Metoda e Depozitave Bankare dhe Shpenzimeve të Kesh-it (në vijim MDBShK)e Udhëzimit Administrativ 15/2010 Neni 30

“MDBShK, llogarit të ardhurat duke treguar çfarë ka ndodhë me fondet e tatimpaguesit. Është e bazuar në teorinë që nëse një tatimpagues merr para, mund të ndodhin vetëm dy gjëra: ato ose mund të depozitohen ose mund të shpenzohen. Kjo metodë bazohet në :

3.2.1 Vërtetimin e depozitave në llogaritë bankare, pas rregullimeve të caktuara që janë bërë për arkëtimet e pa tatueshme, përbën evidencë të arkëtimit të tatueshme “

Ne rastin e larte cekur kemi te bëjmë me transfer te mjeteve nga llogaria e biznesit ne llogarinë personale ne vlere prej 47,000.00€ dhe kthimin e tyre mbas 3 dite. Ky transfer është realizuar me date 31.12.2018 dhe është kthyer me date 03.01.2019 . Këto mjete nuk janë tërhequr nga llogaria personale dhe rrjedhimisht nuk janë shfrytëzuar për qëllime te biznesit. Bazuar ne statusin e biznesit si biznes individual , vlerësojnë se ky transaksion është ndërmjet një entiteti dhe nuk paraqet bazë për vlerësim si qarkullim shtese vlere 47,000.00 €. Po ashtu këto mjete nuk janë te hyrat te realizuara nga biznesi mirëpo janë mjete te shfrytëzuara nga mbitërheqja (overdrafti).

Per vitin 2018 Divizioni i Ankesave do te bej korrigjimet ne kontributet individuale CI pasi qe tatimpaguesi nuk i ka bere deklarimet konform dispozitave ligjore .

Sa i përket vitin 2019 , Divizioni i Ankesave vlerëson se mbetet ne fuqi vlerësimi i inspektorit pasi qe tatimpaguesi nuk ka arrit te dëshmoj deponimet ne vlere 18,000.00€ se është transfer nga llogaria personale dhe prejardhjen e këtyre mjeteve si dhe për huazimin ne vlere prej 23,000.00€ nuk ka vepruar konform Nenit 13 i Ligjit 05/L-028 dhe Udhëzimit Administrativ 01/2016 Neni 19 paragrafi I pika 1.1 dhe 1.2 citojmë :

1. Për qëllim të nenit 13, paragrafit 1, nënparagrafit 1.1. të Ligjit, e ardhur nga interesi në huadhënie konsiderohet çdo e ardhur e përfutur nga dhënia në formën e huas të mjeteve monetare apo mjeteve të ngjashme me to.

1.1. Për këtë kategori të të ardhurave llogaritja e detyrimit tatimor bëhet duke u bazuar në kontratën në mes palëve e cila përcakton:

1.1.1. Shumën e huas;

1.1.2. Afatin e kthimit të huas;

1.1.3. Pranimin-kthimin e huas duhet të bëhet përmes llogarive bankare;

1.1.4. Shkallën e interesit të huas duke u bazuar në vlerën e hapur të tregut.

1.2. Nëse nuk plotësohen kushtet e parapara në nënparagrafin 1.1. të këtij neni, huaja për qëllime tatimore trajtohet e ardhur për pranuesin e saj.

Divizioni i Ankesave konstaton ditari i arkës te cilën e ka prezantuar tatimpaguesi nuk paraqet dëshmi bindëse pasi qe tatimpaguesi ka realizuar tërheqje nga banka duke shfrytëzuar mbitërheqjen deri ne max (50,000.00 €) dhe këto mjete i ka deponuar ne arke derisa ne atë kohe kishe saldo ne arke sillej 50,000-60,000.

Bazuar në ndryshimet e sipër shënuara, Divizioni i Ankesave do të ndryshojë Njoftim Rivlerësimin për Tatim ne të Ardhurat Individuale për periudhën PD 2018 duke e liruuar tatimpaguesin nga qarkullimi shtese ne vlere 47,000.00€,pra total qarkullimi shtese me kontrolle 64,039.20€ rezulton ne vlerën 17,039.20€, ndërsa obligimi tatimor do te zvogëlohet për 4,630.39 € (pa përfshire ndëshkimin dhe interesin), si dhe CI për TM1/2018 , TM2/2018 , TM 3/2018 duke korrigjuar vlerësimet nga 600€ me procedure te kontrollës ne 367.96 € sipas Divizionit te Ankesës.

Pjesa tjetër e obligimit të caktuar me kontroll mbetet obligim për pagesë për tatimpaguesin.

Nga arsyet e theksuar më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi bazuar në nenin 77.2 të Ligjit Nr. 03/L-222, "Për Administratën Tatimore dhe Procedurat", dhe nenin 132/4 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi bazuar në Nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat" 03/L - 222, tatimpaguesi i pakënaqur ka të drejt që brenda afatit (30) ditësh , nga dita e pranimit të Vendimit të Divizionin të Ankesave ,ta kundërshtojë këtë Vendim tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË
Nr.453/2022 datë 06/12/2022

- Vendimi t'iu dorëzohet :
1. Tatimpaguesit
 2. Administratës Tatimore

Udhëheqës i Divizionit të Ankesave
Skender Krasniqi

Kryesuesja e panelit shqyrtues
Ilona Mrasori

